



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2021:160266
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05754396
C.nr.434/2024

GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Avdulla Mecinaj me bashkëpunëtorin profesional Agron Geci, ne çështjen juridike të paditësit B.T., nga fshati..., komuna Skenderaj, të cilin e përfaqëson me autorizim av. Q.R. nga Skenderaj, kundër të paditurës Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për te Rritur, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore e Republikës së Kosovës, për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit gjatë pranisë në punë, në praninë e të autorizuarit të paditësit dhe pa praninë e të paditurës në seancën kryesor publik, me dt.20.05.2024, jep këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.T., nga fshati..., komuna Skenderaj.
- II. Detyrohet e paditura Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim te Rritur ne Prishtinë, që paditësit B.T., në emër të shpenzimeve të udhëtimit në relacionin Skenderaj... dhe anasjelltas për periudhen kohore dt.01.05.2018 deri me dt.21.11.2022 duke llogaritur 70% e biletës prej 1.40 euro, t'i paguaj paditësit për 1022 ditë pune shumë prej 1,001.56 euro, me kamat ligjore në normën prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë nga dt.27.04.2021 deri ne pagesën definitive, në afat prej 7 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nen detyrime te përmbarimit.
- III. Obligohet e paditura Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim te Rritur, që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'i paguaj paditësit B.T. shumë prej 260 euro, në afat prej 7 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi B.T. përmes të autorizuarit në këtë gjykatë ka parashtruar padinë, kundër të paditurës Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim te Rritur, pranë kësaj gjykate me datë 27.04.2021 ka ushtruar padi për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit gjatë punës, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet e paditura, që paditësit t'ia paguaj detyrimin në vlerë prej 70% të biletës së udhëtimit dhe atë prej datës 18.04.2017 e

deri me dt. 23.04.2021 në vlerë totale 840,00 euro, si dhe shpenzimet e procedurës. Tutje në padi ka theksuar se paditësi është punëtor në Shkollën e Mesme... në Skenderaj, ku punëdhënës i fundit ka qenë e paditura dhe që nga data 18.04.2017 i njëjti nuk është kompensuar me 70% të biletës së transportit për secilën ditë të pranisë në punë, duke theksuar se deri në paraqitjen e padisë i ka gjithsejtë 600 ditë pune. Paditësi ka ushtruar edhe kërkesë për realizimin e kësaj të drejte me datë 29.03.2021, mirëpo e njëjta me dt.31.03.2021 ka kthyer përgjigje duke refuzuar kërkesën e palë paditëse. Prandaj duke i pas parasysh të lartcekurat i njëjti përmes përfaqësuesit të tij me autorizim ka ushtruar padi në këtë gjykatë

Gjykata ka vendosur në këtë çështje juridike me Aktgjykimin C.nr.304/2021 të dt.25.09.2023 duke e aprovuar kërkespadinë e paditësit si të bazuar.

E paditura kundër Aktgjykimit C.nr.304/2021 të dt.25.09.2023 ka ushtruar ankesë me dt.27.10.2023 për Gjykatën e Apelit në Prishtinë me propozim që, të aprovohet ankesa e të paditurës, të priset aktgjykimi i shkallës së parë dhe të refuzohet kërkespadia e paditësit si e pabazaur.

Gjykata e Apelit në Prishtinë me Aktvendimin Ac.nr.7820/2023 të dt.03.04.2024 e ka aprovuar ankesën e palës së paditur, duke e prishur Aktgjykimin C.nr.304/2021 të dt.25.09.2023 të Gjykatës Themelore Mitrovicë – Dega në Skenderaj dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje, ku Gjykata e shkallës së parë është udhëzuar që të veprojnë konform vërejtjeve të dhëna nga Gjykata e Apelit.

I autorizuari i palës paditëse në seancën e shqyrtimit kryesor pas kthimit të lëndës në rivendosje deklaroi se, në rastin konkret ka qenë një gabim teknik në vertetimin e të paditurës vetëm sa i përket periudhës kohore, andaj sipas vertetimit të ri, paditësi nga periudha 01.05.2018 deri me dt.21.11.2022 ka gjithësej 1022 ditë pune, ashtuqë kërkespadia duhet të jetë nga dt.01.05.2018 deri me dt.21.11.2022 dhe meqenëse paditësi e ka vendbanimin në fshatin... dhe nuk është kompensuar për shpenzimet e udhëtimit, i propozoj gjykatës që të aprovohet kërkespadia e paditësit si e bazuar dhe të detyrohet e paditura që paditësit për 1022 ditë pune në emër të shpenzimeve të udhëtimit në relacionin Skenderj... që t'i paguaj për 70% të biletës prej 1.40 euro shumën prej 1,001.65 euro, me kamat ligjore 8% nga paraqitja e padisë në gjykatë me dt.27.04.2021 e deri në pagesën definitive.

I kërkoj shpenzimet e procedurës kontestimore për hartimin e padisë shumen prej 104 euro, taksen gjyqësore për padi shumën prej 21 euro dhe për një përfaqësim 135 euro, në shumë të përgjithshme prej 260 euro.

Për palën e paditur nuk mori pjesë askush në seancë, nga shkresat e lëndës rezulton se e njëjta është thirrur në mënyrë të rregullt, me parashitësën e dt.17.05.2024 e paditura ka kërkuar nga gjykata shtyerjen e seancës me arsyetimin se, nuk e kanë pranuar ende Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, por vetëm ftesën për seancë, gjykata në bazë të shkresave në lëndë konstatoj se e paditura Aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.7820/2023 të dt.03.04.2024 e ka pranuar me dt.24.04.2024, andaj lidhur me këtë fakt gjykata shqyrtimin gjyqësor e ka mbajtur pa praninë e saj bazuar në dispozitat e nenit 423 par.4 të LPK-së.

Për vërtetimin e gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete gjykata administroi si prova: kërkesa nr. pro.440/1 e dt.29.03.2021, referenca nr.265/1 e dt:31.03.2021, vërtetimi nr. protokolli 172 i dt.20.05.2024, certifikata e vendbanimit e dt:20.02.2021, vërtetim i ARBK I... BI.

Në kuptim të neneve 7 dhe 8 të LPK, gjykata vlerësoi secilën provë dhe të gjitha se bashku duke vërtetuar këtë gjendje faktike.

Nga kërkesa me nr. pro. 440/1e dt :29.03.2021 u konstatua se paditësi ka kërkuar nga e paditura pagesën për shpenzimet e udhëtimit gjate pranisë në punë.

Bazuar në referencën nr.265/1 e dt:31.03.2021, e paditura ka dhënë përgjigje paditësit sa i përket këtyre pagesave nuk janë parapara ne ligjin për buxhetin po ashtu as ne buxhetin e agjencisë se AAPARr-se dhe kemi kërkuar prej organeve kompetente qe te mundësohet duke na lejuar mjete buxhetore për këtë kategori ekonomike, mirëpo deri me tani kjo nuk ka ndodhur.

Nga vërtetimi me nr. protokolli 172 i dt.20.05.2024 lëshuar nga e paditura, vërtetohet se paditësi është në mardhënje pune si “Mësimdhënës i shkencave natyrore” në... në Skenderaj i regjistruar në librin e të punësuarve 09 dhe nga periudha kohore nga dt.01.05.2018 deri me dt.21.11.2022 ka gjithësej 1022 ditë të pranisë në punë.

Në bazë të certifikatës së vendbanimit numër serik B 10438678 të dt.20.02.2023 konstatohet se paditësi vedbanimin e ka në fshatin..., komuna Skenderaj.

Nga vërtetimi i lëshuar nga NARBK I... BI u konstatua se çmimi për një bilet në relacion... – Skenderaj kushtonë 0.70 centë.

Nuk është kontestues fakti se paditësi është i punësuar tek e paditura, por si çështje kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse është moskompensimi për shpenzimet e udhëtimit për të cilat paditësi pretendon se ka të drejtën e kompensimit, ndërsa e paditura e konteston këtë të drejt me pretendim se një e drejtë e tillë nuk i takon pasi që nuk është në fuqi Kontrata Kolektive dhe se kërkesa është parashkruar.

Gjykata bazën ligjore për aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit e gjenë në Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.1B/2056 e datës 18.04.2017, respektivisht Kontratës Kolektive të Arsimit Nr.01B/105 e dt.22.01.2021, ku sa i përket të drejtës së pagesës në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit në dispozitat e nenit 35 par.5 i kësaj kontrate është përcaktuar se “Punonjësve arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e Komunës përkatëse ku punojnë iu paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”, andaj gjykata bazuar në këtë dispozitë ligjore paditësit ia njohu të drejtën e pagesës në emër të kompensimit për shpenzimet e udhëtimit gjatë pranisë në punë për periudhen kohore nga dt. 01.05.2018 deri me dt.21.11.2022, duke llogaritur 70% të biletës prej 1.40 euro, që i bie të jetë 0.98 euro, për 1022 ditë të pranisë në punë shumën totale prej 1001.56 euro.

Në rastin konkret gjykata i zbatoj dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës nr. 03/L/212 ku shprehimisht thuhet “Marrëveshja kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara në marrëveshje të tillë kolektive”.

Gjykata në bazë të provave të administruara vërtetoi se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e mbështetur në prova faktike të parashtruara me padi si dhe në Kontratën Kolektive të Arsimit dhe në Ligjin e Punës. Më rastin e vendosjes së çështjes konkrete juridike gjykata mori për bazë faktin se e paditura në bazë të dispozitave të nenit 37 të Kontratës Kolektive të Arsimit ka qenë e obliguar që vullnetarisht ta përmbush detyrimin ndaj të punësuarve që i plotësojnë kushtet sipas kontratës së lartpërmendur, por këtë obligim nuk e ka përmbushur, andaj paditësi me të drejtë ka kërkuar mbrojtje gjyqësore.

Në dispozitat e nenit 245 të LMD është përcaktuar se “Kreditori në marrëdhëniet detyimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij”, prandaj Gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditësit me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t’ia kompensoj borxhin në shumat e gjykuara.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e palës se paditur dhe udhëzimet e Gjykatës së Apelit sa i përket pretendimit lidhur me parashkrimin e detyrimit që ka e paditura dhe atë nga dt.18.04.2017 bazuar në nenin 87 Ligjit të Punës, por këto pretendime të të paditurës janë të pabazuara pasi që paditësi në seancën e shqyrtimit kryesor konstatoj se, ka qenë një gabimi teknik në vertetimin e të paditurës sa i përket periudhës kohore ku sipas vërtetimit të lëshuar nga e paditura me dt.20.05.2024 konstatohet se paditësi ka 1022 ditë pune dhe ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit nga periudha kohore dt.01.05.2018 deri me dt.21.11.2022, e në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim, pasi që paditësi me kërkesë iu ka drejtuar të paditurës me dt.29.03.2021, ndërsa padinë në gjykatë e ka ushtruar me dt.27.04.2021, pra paditësi e ka kërkuar të drejtën e tij për kompensim brenda afatit 3 vjeçar ashti siç përcaktohet me dispozitat e nenit 87 Ligji i Punës se “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”.

Ndërsa sa i përket pretendimeve të palës së paditur se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.01 B/2056 e dt.18.04.2017 është lidhur për periudhën kohore prej 3 vitesh, pra i ka kaluar edhe vlerfshmëria e saj me dt.18.04.2020 dhe se kërkespadi së paditësit i mungon baza ligjore, pretendimet e të paditurës nuk qëndrojnë për faktin se, në Kontratën Kolektive të Arsimit Nr.01 B/2056 të dt.18.04.2017, respektivisht në nenin 45 është përcaktuar se “Nëse nga Kontrata Kolektive pasi t’i skadoj afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit. Pas skadimit të afatit të kontratës kolektive, lidhet kontratë e re. Në fillimin e punës së kontratës së re në gjashtëmujorin e parë përdoren rregullat dhe dispozitat e kontratës së vjetër”, andaj bazuar në këto dispozita kjo kontratë kolektive ka qenë në fuqi deri në nënshkrimin e Kontratës së Re Kolektive Nr.01/B 105 e dt.22.01.2021 dhe bazuar në këto dispozita kërkespadia e paditësit e ka plotësisht bazën ligjore dhe me të drejtë ka kërkuar mbrojtje

gjyqësore, andaj këto pretendime nuk janë me ndikim që të vendoset ndryshe nga ajo që është vendosur në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata sa i përket kamatës ligjore në normën prej 8%, është i bazuar në dispozitat e nenit 382 par.1 dhe 2 të LMD nr. 04/L-077 dhe Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 356/2020 te datës 07/12/2022.

Për shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata vendosi ne baze te nenit 452.1 te LPK ne te cilat shpenzime janë llogaritur për hartimin e padis shumë prej 104 euro, taksen gjyqësore për padi shuma prej 21 euro dhe për një përfaqësim shuma prej 135 euro, në shumën e përgjithshme prej 260 euro.

Më sa u tha më lartë konform dispozitat të nenit 143 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ

Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.434/2024 me dt.20.05.2024

Gjyqtari,
Avdulla Mecinaj

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 dite nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit ne Prishtinë.